

**AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISË TREGTARE
SHOQERIA ANONIME
“ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A**

NENI 1

Ne Konispol , sot me daten 24.10. 2017(dymije e shtatembdhjete) , me vullnetin tone te lire dhe te plote krijojme shoqerine Anonime te emertuar

“ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A me aksioner si me poshte:

1.1 Shoqeria ka keta aksionere :

1.1.1. BASHKIA KONISPOL.

NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise **““ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A** eshte ne Qender Konispol.

NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit ne QKB.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKB per të bere shenimet e nevojshme.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare **““ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A** eshte:

4.1.1.Sherbimi i furnizimit me uje te pishem i konsumatoreve dhe shitja e tij.

4.1.2.Mirembajtjen e sistemit te furnizimit me uje te pijshem.

4.1.3.Prodhimin , ose blerja e ujit per plotesimin e kerkesave te konsumatoreve.

NENI 5

5.16.1.

6.1. Kapitali aksionar i shoqërisë është 299,600.000 leke (DYQIND NENTEDHJETE E NENTE MILION E GJASHTË QIND MIJE) lekë dhe përbëhet nga 299.600 aksione , me vlerë nominale secila 1.000 (njëmijë) lekë, të numërtuar në mënyrë progresive nga numri 1 deri tek numri 299.600. Të gjitha aksionet e shoqërisë, pavarësisht nga numërtimi, janë të barazvlefshme. Vlera e Aksioneve eshte kontribut ne natyre.Aksionet jane kontribut ne natyre sipas Nenit 112 te ligjit 9901 date 14.04.2008 Per tregtare dhe Shoqerite tregtare pika 1, dhe 2. Shprehur sipas raportit te Ekspertit te vleresimit (pika 2).

NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim qe merr Asambleja e Aksionereve , i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates. Ne keto raste, vendimi merret nga aksioneret qe perfaqesojne 100% te pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 7

Aksioneret duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise , te ruajne sekretin e saj dhe te mos te demtojne interesat e personave te tjere te shoqerise.

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke dhe ne cdo lloj valute te huaj, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1-Asambleja e Aksionereve .

2-Keshilli Mbykqyres

2-Administratori

Kompetencat e Asamblese se Aksionereve dhe Administratorit do te percaktohen ne statutin e shoqerise tregtare **“ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A**

NENI 10

Shoqeria do te drejtohet nga Administratori i saj Z. LEFTER ISMET BALLABANI, Identifikuar me Nr e Kartes se Identitetit G51009001N.

NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande

NENI 12

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, vecanerisht ,ligjin Nr. Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare"

NENI 13

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne QKR.

NENI 14

Akti i themelimit u perpilia ne 4 (kater) kopje dhe u nenshkrua rregullisht nga ortakët themelues perpara meje noteres e cila vertetohet edhe autenticitetin e tyre.

**THEMELUES TE SHOQERISE
“ UJESJELLES KANALIZIME KONISPOL ” SH.A**

1.1- Bashkia Konispol, perfaqesuar nga SHUAIP BEQIRI

